

**VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË
" REINA" SH.P.K**

Nr.1 Datë: 17 Gusht 2023

Sot më datë 17 Gusht 2023, mbledhet Asambleja e Ortakut të Vetëm të shoqërisë "REINA" SH.P.K, e regjistruar në Shqipëri, me seli në adresën: Berat, Zona Kadastrale nr.8501, Nr. Pasurie 13/76-G5, Volumi 19, faqe 136, me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm (NIPT) M33118002P.

Asambleja e Ortakut të Vetëm përbëhet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë Z.Alket Ngjeqari, i cili zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë REINA" SH.P.K. Mbledhja mbahet në Berat, në selinë e shoqërisë, dhe Ortaku është prezent në mbledhje.

Rendi i Ditës :

Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë REINA SHPK në formë monetare me burime nga jashtë shoqërisë.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë konfirmon se i gjithë Kapitali i Shoqërisë është i përfaqësuar dhe se të gjithë kërkesat për të thirrur një Mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve janë përmbushur në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe Statutin e Shoqërisë.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË, UNANIMISHT:

1.Vendosi zmadhimin e kapitalit të shoqërisë REINA SHPK me Nipt M33118002P, në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar referuar nenit 145, pika 1 dhe Nenit 168 dhe 169 të këtij ligji që janë të zbatueshme për rastin e zmadhimit të kapitalit.

Zmadhimi i kapitalit realizohet nëpërmjet burimeve në formë monetare nga jashtë shoqërisë, konkretisht dividendet neto në shumën 6,188,394 lekë që Ortaku i vetëm i Shoqërisë ka përfituar nga Shoqëria DAED sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve nr.1, datë 30.06.2023.

Zmadhimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zmadhimit të vlerës së kuotës së kapitalit, nga 12,549,600 lekë në 18,737,994 lekë, pra kuota e kapitalit zmadhohet me 6,188,394 lekë (55,999 Euro).

Kapitali i shoqërisë REINA SHPK nga 12,549,600 lekë bëhet 18,737,994 lekë, i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 18,737,994, e cila zotërohet 100% nga ortaku i vetëm Z.Alket Ngjeqari.

Kapitali themeltar i shoqërisë në vlerën 12, 549,600 leke (120,000 Euro, kursi 1 Euro= 104.58 All), është shlyer plotësisht në datë 16.08.2023.

Shoqëria REINA SHPK është regjistruar në 18.07.2023 dhe për vitin ushtrimor 2023, ndryshimet në Pasqyrën e kapitalit do jone si me poshtë:

Kapitali dhe Rezervat	Periudha viti 2023	Periudha viti 2023
	Pas Zmadhimit	Para Zmadhimit
Kapitali i nënshkruar	18,737,994	12,549,600
Rezerva (ligjore, statutore, etj)		
Fitime/(Humbje) të mbartura		
Fitime/(Humbje) të periudhës financiare		
Shuma e Kapitalit	18,737,994	12,549,600

Përfundimisht:

Vlera Kapitalit të shoqërisë ishte 12,549,600 lekë dhe bëhet 18,737,994 lekë

Vlera nominale e kuotës së kapitalit ishte 12,549,600 bëhet 18,737,994 lekë

2.Vendimi për Zmadhimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga Administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

3.Kapitali quhet i zmadhuar, duke filluar nga çasti i regjistrimit të Vendimit.

4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i shoqërisë Z.Alket Ngjeqari.

Asnjë vendim tjetër nuk u mor në këtë Mbledhje të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të REINA SHPK

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Ortaku i Vetëm i REINA SHPK, përfaqësuesi i 100 % të kapitalit të Shoqërisë, me vullnetin tij të plotë dhe të lirë, firmosi këtë dokument.

ORTAKU I VETËM

REINA Sh.p.k.

Alket Ngjeqari